



Pranuar / Dorezuar Prilimno/Prodato Received/Delivered	13.03.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKSTOK	2569/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.217/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.217/2023 të datës 12.01.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2022, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.217/2023 e datës 27.01.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet ne fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 01.02.2023 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin për vitin 2022.

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, i pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë, më datë 27.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, e cila është protokolluar me numër:986/2023 nën shenjë A.nr.217/2023, kundër Formularit për Vlerësimin e Punës të datës 31.01.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill me pretendon se së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, pasi që ankuesi meriton notë me të lartë të vlerësimit lidhur me

arritjen e objektivave si dhe sjellën profesionale, sikurse për objektiv i renditur me numër katër (4) e për të cilën është vlerësuar me notën tre (3) nuk ka qenë pjesë objektivave të punës për vitin 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 03.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 28.02.2023 ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 27.01.2023 me Nr.Prot:986/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit me numër Prot:92/2012 të ankuesit të datës 13.04.2012; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2023 i datës 09.01.2023; Shkresën "Print screen" i sistemit elektronik të SIMBNJ; E-mailin e datës 24.01.2023 dërguar nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 23.01.2023 dërguar nga ankuesi për _____ E-mailin e datës 11.01.2023 dërguar nga sistemi elektronik i SIMBNJ-së për ankuesin; Shkresën "Print screen" i sistemit elektronik të SIMBNJ me njoftimin për vlerësimin e rezultateve në punë; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.02.2023 me numër prot:1387/2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 28.02.2023 me numër prot:2140/2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për Grumbullimin dhe Përpunim të Informatave; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 01.02.2023 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin për vitin 2022; E-mailin e datës 03.02.2022 dërguar nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 04.02.2022 dërguar nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 07.10.2022 dërguar nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 10.11.2022 dërguar nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 27.02.2023 dërguar nga _____ për _____

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e *pabazuar*, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 13.04.2012 mbanë pozitën "Zyrtar i lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave" në Departamentin: Qendra e Situatave në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ndërsa udhëheqësi i ti i drejtpërdrejtë përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë i datës 09.01.2023 ankuesi është vlerësuar fillimisht me notën e përgjithshme mesatare tre pikë shtatë (3.7), mirëpo i njëjti kishte shpreh kundërshtimin lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë përmes e-mailit të datës 24.01.2024 tek Menaxherja e Burimeve Njerëzore, ndërsa udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë me datë 01.02.2023 e kishte ri-vlerësuar ankuesin me notën e përgjithshme katër (4).

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sa i përket notës së përgjithshme të vlerësimit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: "Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.4. nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë"; dhe"



ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 i të njëjtit nen dhe rregullore ku përcaktohet se: “Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: *“shumë mirë”*, vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”, prandaj marrë për bazë Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për ankuesin i datës 01.02.2023 përmes të cilat ankuesi ishte rivlerësuar me notë të përgjithshme mesatare katër (4), Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se ankuesi është vlerësuar *“shumë mirë”* në kuptim të dispozitave të lartcekura të rregullores, nga rrjedh si i njëjti cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit i paraqitur në ankesën e datës 27.01.2023 të parashtruar në Këshill është i pabazuar, ngase udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë nuk ia ka mohuar përkushtimin në punë sikurse as realizimin e të gjitha objektivave, gjegjësisht të njëjtin e ka vlerësuar përtej pritjeve.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit vlerëson se është për tu theksuar fakti se ankuesi formularin e datës 01.02.2023 përmes të cilit ishte vlerësuar me notë të përgjithshme katër (4) e ka nënshkruar me datë 02.02.2023 me vërejtje vetëm sa i përket objektivit të përcaktuar me numrin rendor katër (4), ndërsa për pjesën tjetër ka lënë të nënkuptojë se ka pajtueshmëri dhe se për një gjë të tillë nuk ka bërë plotësimin e ankesës të parashtruar në Këshill me datë 27.01.2023, ngase pretendimet e tij ankimore ishin më të gjera, gjegjësisht i njëjti pretendonte se përmes vlerësimit fillestar të datës 09.01.2023 i ishte mohuar vlerësimi real sa i përket arritjes së objektivave.

Lidhur me pretendimin e ankuesit sa i përket kontestimit të objektivit të përcaktuar në numrin rendor katër (4) për të cilën është vlerësuar me notën e vlerësimit tre (3) i cili është i përcaktuar si në vijim: *“4. Monitorimi i përditshëm i mediave elektronike dhe të shkruara në Kosovë, duke përcjellë gjithë materialet ditore që kanë të bëjnë me sigurinë në Kosovë”*, ka gjetur se sipas formularit për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën të cilën e mban ankuesi *“Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave”* njëra ndër detyrat kryesore është edhe detyra e përcaktuar në numrin katër (4), si vijon: *“Monitorimi i përditshëm i mediave elektronike dhe të shkruara në Kosovë, duke përcjellë gjithë materialet ditore që kanë të bëjnë me sigurinë në Kosovë”*, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm ngase një objektiv i tillë është i përcaktuar edhe në përshkrimin zyrtar të detyrave të punës për pozitën që mban ankuesi, prandaj kontestimi se një detyrë e tillë e punës nuk ka qenë e përcaktuar si objektiv është i pabazuar ngase objektivat rrjedhin dhe kanë lidhshmëri të ngushtë me përshkrimin zyrtar të detyrave të punës për të cilat ankuesi ka qenë në dijeni përderisa është i emëruar me akt emërim të karrierës.

Prandaj, nga analizimi i shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sikurse edhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme mesatare *“katër (4)-shumë mirë”* e që në kuptim të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik vlerësohet se i njëjti jo vetëm që i ka arritur të gjitha objektivat punës por ka ndikuar edhe performancën e përgjithshme të institucionit, prandaj mbi këtë bazë udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si



dhe nenin 7 të së njëjtës rregullore, ngase ankuesi është vlerësuar edhe për arritjen e objektivave sikurse edhe për sjelljet profesionale, dhe po ashtu nga e-maillet e datës 03.02.2022, 04.02.2022, 07.10.2022 dhe 10.11.2022 dërguar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë për ankuesin konstatohet fakti se udhëheqës i tij e ka mbajtur nën vëzhgim sipas detyrës zyrtare performancën e ankuesit në arritjen e objektivave, sikurse e ka sugjeruar për përmirësim të mëtutjeshëm, andaj mbi këtë bazë si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar sikurse e njëjta është refuzuara si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa vlerësimi i rezultateve të punës të ankuesit për vitin 2022 të konkretizuara përmes formularit të datës 01.02.2023 është vlerësim i drejtë dhe i ligjshëm dhe i njëjti ka mbetur në fuqi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.217/2023

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.